



Drejtoria për Arsim

Nr. 117-1500/22

Klinë, 07-03-2022

Duke u bazuar në nenin 67 dhe 68 të ligjit të Zyrtareve Publik Nr. 06/L-114, nenit 8 të ligjit të Punës nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit të Arsimit Parauniversitar nr. 04/L-32, nenin 5, pika c, të Ligjit nr. 03/L 068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017, UA 05/2021 Normativin mbi kuadrin profesional të Arsimit të Përgjithshëm, UA 05/2015 Normativin për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit shpall:

### KONKURS I JASHEM

Për pozitën e lirë si në vijim:

- 1 Mësimdhënës për Lëndën e Filozofisë – SHML “Luigj Gurakuqi” në Klinë pozitë e lirë, 10 orë.

Koeficienti: 6.36 për mësimdhënës në shkolla të mesme të larta;

Kualifikimi: Sipas UA 05/2021 –Normativin mbi kuadrin profesional të Arsimit të Përgjithshëm, UA 05/2015 Normativin për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional

#### Përshkrimi i detyrave punuese:

- Të realizojë plan-programin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore;
- Të përgatisë me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditor në përputhje me kurrikulën, e në pajtim me kërkesat për përshtatjen e mësimdhënies aftësive dhe prirjeve individuale të çdo nxënësi;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare;
- Të kontrollojë me rregull dhe të mbajë evidencën për suksesin dhe progresin individual të secilit nxënës, si dhe të jetë në gjendje t' i raportojë prindit apo kujdestarit të familjes;
- Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e programeve dhe aktiviteteve të tjera në shkollë, kur kërkohet nga drejtori i shkollës;
- Të kujdeset për zhvillim të vazhdueshëm profesional individual ;
- I punësuar është i obliguar të respektojë kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore;
- Bashkëpunon me organet e shkollës dhe me të gjitha institucionet tjera profesionale.

#### Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Aplikacioni i punësimit
2. Kopja e dokumentit të identifikimit (letërnjoftimi)
3. Diploma e vërtetuar te noteri publik
4. Certifikata e diplomimit jo më e vjetër se gjashtë muaj e vërtetuar te noteri
5. Certifikata që nuk është nën hetime merret ne Gjykatë
6. Ekstrakti i lindjes.

#### Mënyra e aplikimit:

- Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në Drejtorinë e Arsimit .
- Formulari i aplikimit mund të shkarkohet webfaqja e Komunës së Klinës
- Rekrutimi: intervista me shkrim dhe gojë dhe përzgjedhjen e kandidatëve bëhet nga Komisioni i përzgjedhur nga DKA
- Marrëdhënia e punës themelohet vetëm nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës
- Afati i aplikimit fillon nga data 07-04-2022 deri me 16-04-2022, ora 16:00.
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen.

Rezultatet shpallen në ueb faqen e komunës.



04 Uprava za Obrazovanje

Br. 111-7500/22  
Klina, 07-03-2022

Na osnovu člana 67. i 68. Zakona o javnim službenicima br. 06 / L-114, član 8 Zakona o radu br. 03 / L-212, član 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju br. 04 / L-32, član 5, tačka c, Zakona br. 03 / L 068 o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo i Administrativno uputstvo br. 07/2017, AI 05/2021 Normativ za stručno osoblje opšteg obrazovanja, AI 05/2015 Normativ za nastavnike stručnog obrazovanja, direktor Uprave za obrazovanje objavljuje:

### JAVNI KONKURS

Za popunjavanje slobodnog radno mesta:

- **1 Nastavnik predmeta Filozofije u VSS "Luigj Gurakuqi" Klina**

**Koeficijent: 6.36 za nastavnike u višim srednjim školama;**

Potrebna Kvalifikacija: Prema AU 05/2021 - Normativ za stručno osoblje opšteg obrazovanja, AU 05/2015 Normativ za nastavnike stručnog obrazovanja

Opis posla:

- Sprovesti nastavni plan i program za odgovarajuće radno mesto na osnovu Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo i drugih podzakonskih akata;
- Pripremati redovno godišnji, mesečni i dnevni nastavni plan i program u skladu sa nastavnim planom i programom, a u skladu sa zahtevima za prilagođavanje nastavnih veština i individualnih sklonosti svakog učenika;
- Implementirati nove metodologije nastave i ocenjivanja u skladu sa nastavnim smjernicama;
- Redovno proveravajte i vodite evidenciju o pojedinačnom uspehu i napretku svakog učenika, kao i moći da izveštavate roditelja ili staratelja porodice;
- Da aktivno učestvuje u pripremi programa i drugih aktivnosti u školi, po zahtevu direktor škole;
- Stara se o stalnom individualnom profesionalnom razvoju;
- Zaposleni je dužan da poštuje pravila oblačenja i ponašanja, definisana unutrašnjim propisima škole i drugim zakonskim i podzakonskim aktima;

Potrebna dokumenta za prijavu:

1. Prijava za zapošljavanje
2. Kopija identifikacionog dokumenta (lična karta)
3. Overena diploma kod javnog beležnika
4. Potvrda o diplomiranju ne starija od šest meseci overena kod notara
5. Potvrda koja nije pod istragom
6. Izvod iz matične knjige rođenih.

Rok za prijavu pocinje od 07-04-2022 do 17-04-2022, 16.00.

Rezultati bice objavljeni preko veb stranici opstine.

Dokumenti se predaju u fuizicke kopije i ostaju u arhivi uprave.

